

# STATUT

## I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

### SUFA PIPE

#### KAPITULLI I

##### Formimi, Emërtimi, Objekti, Kohëzgjatja dhe Adresa Kryesore

###### Neni 1

###### Data e themelimit, Emri dhe Themeluesit


1. Data e themelimit te shoqerise eshte **16 Shtator 2021**.
2. Kjo shoqeri do te jete nje **Shoqeri me Pergjegjesi te Kufizuar**, veprimtaria e te ciles rregullohet nga Statuti dhe nga legjislacioni ne fuqi. Shoqeria vepron sipas legjislacionit shqiptar ne fuqi.
3. Themeluesit e shoqërisë janë:
  - **Ajet Sufa**, atesia Sejdi, lindur ne 01.11.1964 ne Diber, banues ne Damjan-Tirane rregjistruar me ID G41101134K.
  - **Qatip Sufa**, atesia Mexhit, lindur ne 16.05.1954 ne Diber, banues ne Damjan-Tirane rregjistruar me ID F40516087J.
  - **Sabit Sufa**, atesia Mexhit, lindur ne 27.06.1960 ne Diber, banues ne Damjan-Tirane rregjistruar me ID G00627135T.
  - **Bezat Sufa**, atesia Mexhit, lindur ne 02.05.1963 ne Diber, banues ne Damjan-Tirane rregjistruar me ID G30502196Q.
  - **Izet Sufa**, atesia Mexhit, lindur ne 25.04.1970 ne Diber, banues ne Damjan-Tirane rregjistruar me ID H00425072C.
  - **Lulëzim Sufa**, atesia Sejdi, lindur ne 23.05.1970 ne Diber, banues ne Damjan-Tirane rregjistruar me ID H00523032N.

###### Neni 2

###### Objekti

Shoqëria do të kryejë veprimtaritë që vijojnë:

Prodhim dhe tregetim llullash, perpunim dhe tregetim te rrenjes se shqopes dhe mares si dhe shtimin e pyjeve, pyllzime, permiresime pyjore, sistemime malore, shfrytezimin e pyjeve, rruget pyjore, mbareshtimin e flores spontane, mjekesore e tanifere, mbareshtimin e faunes dhe gjuetine sportive e turistike, mbrojtjen nga semundjet, demtuesit dhe zjarret, mbareshtimin e kullotave dhe livadheve, ndertimin dhe meremetimin e veprave per sigurimin e ujit te pijshem ne kullova e livadhe.



Tregetimin me shumice e pakice te mallrave te ndryshem ushqimor, industrial, fruta perime, pajisje elektrike, elektroshtepiake, mallra te te gjitha llojeve, materiale dhe pajisje te ketyre mallrave industriale, prodhimi dhe tregetimi i pjeseve te tyre te kembimit.  
Eksport-Import te te gjitha mallrave dhe materialeve.

### **Neni 3**

#### **Kohëzgjatja**

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë e papërcaktuar. Shoqëria mund të priset përpara këtij afati me vendim të Asamblesë së Ortakeve.

### **Neni 4**

#### **Adresa e shoqërisë (Selia)**

1. Adresa e shoqërisë **SUFA PIPE** është në: **Lagjja "Sultaf", Godine Private 1 Kateshe Nr.3, Damjan, Vaqarr, TIRANE.**
2. Transferimi i selisë së shoqërisë në një vend tjetër bëhet me vendim të asamblesë së ortakeve.
3. Asambleja e ortakeve mund të vendosë hapjen e filialeve, selive dytesore, degeve dhe perfaqësive në qytete të tjera të Shqipërisë dhe jashtë vendit.
4. Asambleja e shoqërisë mund të delegojë këto kompetence organit administrativ.

## **KAPITULLI II**


### **KAPITALI**

#### **Neni 5**

#### **Kapitali themeltar**

Kapitali fillestar i regjistruar i shoqërisë është 1.680.000 lekë, kontribut në likuiditete të ortakeve, në total 6 (gjashtë) kuotave. Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin themeltar të kompanisë është në përputhje me kontributet e tyre si vijon:

1. Ortak Themelimi Ajet Sufa: zoterues i 1 (një) kuote me një vlerë të përgjithshme 280.000 lekë që përbën 16.67% të kapitalit themeltar të shoqërisë.
2. Ortak Themelimi Qatip Sufa: zoterues i 1 (një) kuote me një vlerë të përgjithshme 280.000 lekë që përbën 16.67% të kapitalit themeltar të shoqërisë.
3. Ortak Themelimi Sabit Sufa: zoterues i 1 (një) kuote me një vlerë të përgjithshme 280.000 lekë që përbën 16.67% të kapitalit themeltar të shoqërisë.
4. Ortak Themelimi Bezat Sufa: zoterues i 1 (një) kuote me një vlerë të përgjithshme 280.000 lekë që përbën 16.67% të kapitalit themeltar të shoqërisë.



Eksperti ka detyrimin për të kontrolluar të gjithë dokumentacionin kontabël të veprimtarisë ekonomike të shoqërisë tregtare, kontrollin vjetor dhe periodik të kryer prej tij në rastet kur ai është emëruar dhe ka kryer detyrën e tillë të ngarkuar nga ortakët

Në fund të kontrollit, auditori i çertifikuar përgatit raportin, me shkrim, për nxjerrjen e rezultateve të llogarisë vjetore, si dhe raportin për kontrollet periodike, i cili është i detyruar tua paraqesë në kohë ortakëve për shqyrtim dhe miratim bazuar në të drejtën e tyre për të votuar.

## **Kapitulli V**

### **Prishja - Riorganizimi i Shoqërisë**

#### **Neni 17**

#### **Prishja dhe Likuidimi**

Shoqëria mund të prishet në çdo kohë, në rrethanat e mëposhtme:

- Kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
- Me vendim të Asamblesë së Përgjithshme;
- Me hapjen e procedurave të falimentimit;
- Nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk ka njoftuar pezullimin e veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 i Ligjit Nr 9723 "Për Qendrën Kombëtare të Biznesit";
- Me vendim të gjykatës;

Në këtë rast Ortakët marrin vendimin, me shkrim, në të cilat parashikojnë mënyrën e likuidimit të shoqërisë duke caktuar një ose më shumë likuidatorë, dhe të gjitha dokumentet e lëshuara nga shoqëria duhet të ketë emrin e likuiduesve dhe emërimin shtesë "Shoqëri në likuidim".

Me përjashtim të rastit kur është nisur procedura e falimentimit prishja e shoqërisë tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese.

Likuidimi kryhet nga likuiduesit në emër të Ortakëve.

Kur ortakët nuk marrin një vendim mbi emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditë pas prishjes çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës për të caktuar një likuidues.

#### **Neni 18**

#### **Riorganizimi i shoqërisë Bashkimi - Ndarja**

Shoqëria mund të ndahet, bashkohet në bazë të Vendimit të Asamblesë së Përgjithshme të ortakëve sipas dispozitave ligjore të parashikuara në Pjesën IX të Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2012 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare"

#### **Neni 19**

**Baza ligjore**

e) raportojnë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe realizimin e veprimeve me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë;

ë) Kryejnë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.

Administratori/ët janë të detyruar të thërrasin Asamblenë e Përgjithshme në rastet kur:

- Sipas bilancit vjetor apo raporteve të përmjetme financiare rezultojnë ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim;

- Shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5% të asetëve të shoqërisë, që rezultojnë në pasqyrat e fundit financiare të çertifikuara;

- Shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit, propozon për të blerë asetet që i përkasin një ortaku që kanë një vlerë më të lartë se 5% të asetëve të shoqërisë që rezultojnë në pasqyrat e fundit financiare të çertifikuara;

Nëse Asambleja e Përgjithshme emëron më shumë se një administrator, ata e administrojnë bashkërisht shoqërinë.

Asambleja e Përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Çdo pretendim, përsa i përket kompensimit të administratorit, rrjedh nga marrëdhëniet kontraktuale që rregullohen nga dispozitat ligjore në fuqi.

## Neni 14

### Përgjegjësitë e administratorit

Administratori është përgjegjës ndaj Shoqërisë ose palëve të treta për dëmet e shkaktuara nga shkelja e ligjeve, të Statutit, apo për gabimet e kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

Pasojat për çdo marrëveshje të pamiratur nga Asambleja, që i sjellin dëme shoqërisë, bien mbi administratorin dhe ortakun që kanë bërë marrëveshjen personalisht e në mënyrë solidare.

Përveç sa parashikohet në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 dhe 18 të ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare, administratori është i detyruar që të:


a) Kryejë detyrat e tij të përcaktuara me ligj ose në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi duke i kushtuar vemëndje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjedis;

b) Ushtrijë kompetencat që i njihen me ligj ose në Statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;

c) Të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;

ç) Të parandalojë dhe mënjanojë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm të interesave personale me ato të shoqërisë;

d) Të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizëm dhe kujdesin e nevojshëm.



Administratori gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjet ndaj shoqërisë për çdo veprim apo mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi apo mosveprimi është kryer në mirëbesim.

Në rastin kur administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standardet profesionale, sipas pikave 1 dhe 2 të këtij neni, ai është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojë çdo fitim personal që ai apo personat e lidhur me të, kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratori ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tij në mënyrë të rregullt e sipas standarteve të kërkuara. Në rast se shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidare.

Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, Administratori është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e ligjit "Për të tregtarët dhe shoqëritë tregtare, kryen veprimet e mëposhtme:

- a) Kthimin e kontributeve ortakëve;
- b) Pagan ortakëve interesa apo dividendë;
- c) Shpërndan aktivet shoqërisë;
- ç) Lejon që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare, kur në bazë të gjëndjes financiare, duhej të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet;
- d) Jep kredi

Përveç kërkesës për dëmshpërblimin e dëmeve që i atribuohen administratorit, ortakët personalisht apo në mënyrë solidare, kanë të drejtë të paraqesin padi penale kundër administratorit.

Paditësit kanë të drejtë të ndjekin mjetet ligjore për shlyerjen e plotë të dëmeve të shkaktuara shoqërisë, duke përfshirë kompensimin financiar, nëse është e nevojshme.

## **Kapitulli IV**

### **Viti Financiar - Eksperti**

#### **Neni 15**


#### **Viti Financiar**

Viti financiar fillon më 1 janar dhe përfundon më 31 dhjetor të çdo viti kalendarik. Me përjashtim të vitit të parë financiar, që fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit, dhe mbyllet më 31 dhjetor.

#### **Neni 16**

#### **Ekspertët**

Eksperti emërohet nga ortakët, nëse kërkohet me ligj.



Kur një ortak përfaqësohet nga një përfaqësues i autorizuar, i autorizuari vlerësohet të jetë në të njëjtin konflikt interesi, ashtu si dhe ortaku të cilin përfaqëson.

## Neni 12

### Administrata

1. Asambleja e përgjithshme emëron një ose më shumë persona (individ) si administrator të shoqërisë për një afat të përcaktuar nga Statuti që nuk i kalon 5 vjet, me të drejtë rizgjedhje. Emërimi ka efekt ligjor pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit.
2. Administratori/ët e një shoqërie tregtare mëmë sipas nenit 207 të këtij ligji nuk mund të emërohen administratorë të një shoqërie të kontrolluar dhe anasjelltas. Çdo emërim i bërë në kundërshtim me këtë dispozitë është i pavlefshëm.
3. Personi i mëposhtëm është emëruar si **administrator i parë i shoqërisë me afat të përcaktuar 5 (pese) vjet me të drejtë shtyrje afati.**

**Sabit Mexhit Sufa me ID G00627135T**

**Lindur në Diber, Shqiperi**

**Banues në Tirane**

Administratori do të ketë vetëm fuqinë për të përfaqësuar shoqërinë për qëllime tregtare dhe marketingu sipas limiteve dhe kriterëve të përcaktuara në kontratën e marrëveshjes. Çdo përjashtim mund të vendoset më pas me anë të Kontratës së shkruar dhe miratuar nga të dyja palët.

## Neni 13

### Të drejtat dhe detyrimet e administratorëve

Administratorët kanë të drejtë e detyrohen të:

- a) kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikën tregtare të vendosura nga Asambleja e Përgjithshme;
- b) përfaqësojnë shoqërinë tregtare;
- c) Të kujdesen për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumentave dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- ç) përgatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve i paraqesin këto dokumenta përpara Asamblesë së Përgjithshme për miratim;
- d) krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat që kërcenojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- dh) kryejnë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë siç parashikohet në Ligjin për Qendrën Kombëtare të Biznesit;



Asambleja e Përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë ose postës elektronike duhet të përmbajë vendin, datën dhe orën e mbledhjes dhe t'u dërgohet së bashku me rendin e ditës të gjithë anëtarëve jo më vonë se 7 ditë para datës së parashikuar të takimit.

Kur Asambleja e Përgjithshme nuk është thirrur sipas Paragrafit 1, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm në qoftë se të gjithë ortakët e shoqërisë bien dakord për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

## Neni 10

### Marrja e vendimeve

Asambleja e Përgjithshme vendos vetem me votim të plotë të aksionereve për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Asambleja e përgjithshme vendos me votim të plotë të ortakëve pjesëmarrës për çështje të tjera, si:

- Përcaktimin e politikave tregtare;
- Emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- Emërimin e shkarkimin e auditorëve të pavarur dhe të likuiduesve;
- Përcaktimin e shpërblimeve;
- Monitorimin dhe mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- Përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- Miratimin e rregullave procedurale për mbajtjen e Asamblesë së Përgjithshme


Çdo ndryshim në statut duhet të dorëzohet në QKB për të pasqyruar ndryshimet në dosjen e shoqërisë.

## Neni 11

### Përfshirja nga e drejta e votës

Një ortak nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës nëse Asambleja e Përgjithshme merr vendim për:

- a) Vlerësimin e veprimtarisë së tij
- b) Shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij
- c) Çdo pretendim kundër tij në emër të shoqërisë
- ç) Dhënieve ose jo të përfitimeve të reja



## VENDIMARRJA DHE ORGANET DREJTUESE

### Neni 8

#### Organi i Vendim - Marrjes

Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve është i vetmi organ vendimmarrës i shoqërisë.

Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve është i vetmi organ vendimmarrës i shoqërisë që miraton çdo ndryshim në statut sipas modaliteteve të parashikuara nga Ligji.

Asambleja e Përgjithshme merr vendime për çështjet e mëposhtme të shoqërisë:

- a) Përcaktimin e politikave tregtare;
- b) Ndryshimet ne statut;
- c) Emërimin e shkarkimin e administratorit/eve;
- ç) Emërimin e shkarkimin e likuiduesit/ve dhe te ekspertit/eve kontabël;
- d) Përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në pikat "c" dhe "ç";
- dh) Monitorimin dhe mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- e) Miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- ë) Destinimin e fitimeve vjetore;
- f) Zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- g) Pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- h) Përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratoreve;
- i) Riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- j) Miratimin e rregullave procedurale të saj;
- k) Çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo Statuti.


Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.

Administratori i shoqërisë nuk mund të veprojë si një përfaqësues i një ortaku tjetër në Asamblenë e Përgjithshme.

Autorizimi mund të jepet vetëm për një Mbledhje te Asamblesë së Përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

### Neni 9

#### Mënyra e thirrjes së Asamblesë Përgjithshme





5. Ortak Themelimi Izet Sufa: zoterues i 1 (nje) kuote me nje vlere te pergjithshme 280.000 lek që përbën 16.66% të kapitalit themeltar të shoqërisë.
6. Ortak Themelimi Lulëzim Sufa: zoterues i 1 (nje) kuote me nje vlere te pergjithshme 280.000 lek që përbën 16.66% të kapitalit themeltar të shoqërisë.

Kontributi i ortakëve eshte në likujditete.

## Neni 6

### Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit

Kapitali i shoqërisë mund të rritet përmes emetimit të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributin në para, në natyrë nëpërmjet emërimit nga gjykata kompetente te një eksperti të autorizuar për këto kontribute sipas kërkesave të Administratorit. Kapitali i shoqërisë mund te rritet pa kufi ne cdo moment, nje ose disa here ne perputhje me legjislacionin ne fuqi. Rritja e kapitalit behet vetem me vendim te Asamblese se Ortakeve.

Shumica nuk mund të detyrojë, në asnjë rrethanë, një ortak për të rritur kontributin e tij në kapitalin themeltar të shoqërisë.

Zvogëlimi i kapitalit lejohet nga Asambleja e Përgjithshme, e cila do të marrë vendimin në të njëjtat kushte si për rishikimin e Statutit.

Në të gjitha rastet zvogëlimi i kapitalit ndikon ortakët në të njëjtën masë aq sa pjesa e tyre përkatëse në kapital.

## Neni 7

### Transferimi i kuotave

Kuotat dhe të drejtat që rrjedhin pret tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- Pjesëmarrjes në kapitalin e shoqërisë ne momentin e themelimit të shoqërisë;
- Blerjes;
- Trashëgimisë;
- Dhurimit;
- Mënyra të tjera të parashikuara me ligj.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve, përveçse kur parashikohet ndryshe në statut. Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me anë të trashëgimisë.

Transferimi i kuotave kushtezohet nga e drejta e parablerjes se ortakeve. Ne nje rast te tille ortaku qe do te transferoj kuotat e tij te kapitalit duhet ti njoftoje ortakët e tjere nepermjet menyrave te njohura te njoftimit.

**KAPITULLI III**



Shoqëria do të zhvillojë veprimtarinë e saj në përputhje me këtë Statut dhe dispozitave ligjore të legjislacionit shqiptar.

Përveçse kur parashikohet ndryshe në këtë Statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", Kodit Civil dhe çdo ligj tjetër i veçantë i Republikës së Shqipërisë.







## Neni 20

### Mosmarrëveshjet

Çdo mosmarrëveshje që lind në lidhje me zbatimin ose interpretimin e këtij Statuti, si dhe çdo mosmarrëveshje ndërmjet kompanisë dhe palëve të treta, do t'i referohen Gjykatës Shqiptare.

Ortakët e **SUFA PIPE** shpk

Emri Mbiemri

1. Ajet Sufa 
2. Qatip Sufa 
3. Sabit Sufa 
4. Bezat Sufa 
5. Izet Sufa 
6. Lulëzim Sufa 

Tirane 16 Shtator 2021